

Tiranë

27/09/2022

Kontakt:

Elton Tirana

E-mail:

[elton.tirana@studiotirana.com](mailto:elton.tirana@studiotirana.com)

Cel: +355 699 325 722



**Drejtuar : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë 1007**

**Në vëmendje të: Z. Ylli Merkaj**

**Objekti: Njoftim mbi mosrealizimin e kryerjes së misionit të auditimit për  
Partinë G99**

Të nderuar Zotërinj,

Bazuar në Kontratën nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Liçensuar (Auditues Ligjor) me misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve për vitin kalendarik 2021 për Partinë G99, ju bëjmë me dijeni se nga komunikimi dhe dokumentacioni vërtetues i pajisur nga subjekti politik, jemi informuar se Parti G99 ka qenë në statusin Pasiv gjatë vitit 2021 dhe nuk ka përgatitur dhe dorëzuar Pasqyra Financiare. Në këto kushte ne nuk mund të kryejmë auditimin tonë sipas kërkesave të SNA-ve dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012).

Kemi arritur të sigurojmë vërtetimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me statusin pasiv të subjektit politik si dhe një përgjigje nga Partia G99 lidhur me kërkesën tonë, e cila informon se nuk ka përfutuar fonde nga KQZ apo burime të tjera.

Si konkluzion, për shkak se procedurat dhe evidenca e mësipërme nuk paraqesin dhe plotësojnë kushtet për auditim në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, ne nuk mund të shprehim asnjë opinion për fonde të përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit 2021 nga Partia G99.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj.

Me respekt,

Elton Tirana



Shtator 27, 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TIRANË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE

Nr. 2422 Prot

Tiranë, më 16/09/2022

Lënda: Kthim Përgjigje

PARTIA POLITIKE G99, NIPT L21310451D  
BUL B.CURRI PALLAGIMI SH.4 AP., Tirane

Përgjigje të kërkesës tuaj me nr.cështje E00000990846 datë 16.09.2022, vërtetojmë se Subjekti Person Fizik/Juridik PARTIA POLITIKE G99 me NIPT L21310451D me administrator Z. ERVIN METE, dhe me objekt veprimtarie: Aktivitete të organizatave politike...etj rezulton me ndryshime në status si më poshtë vijon:

Nr.	DATA NGA	DATA DERI	STATUSI
1	10/01/2012	25/06/2019	AKTIV
2	26/06/2019		PASIV

Ky vërtetim jepet për efekt Dokumenti.

DREJTOR I SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE

Edvin Grueka

